REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr._____/2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.29, DATË 30.3.2023, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.29, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas shkronjës "dh", të pikës 19, të nenit 3, shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) shumat e dhëna nga entiteti në formën e paradhënieve, huave ose formave të tjera të financimit në favor të ortakëve apo të aksionarëve, kur këto shuma nuk përfaqësojnë transaksione financiare reale ose shlyerje të detyrimeve ekzistuese, por, sipas përmbajtjes së tyre ekonomike, përbëjnë shpërndarje të tërthortë të fitimit.".

Neni 2

Pas shkronjës "g", të nenit 11, shtohet shkronja "gj", me këtë përmbajtje:

"gj) të ardhurat personale të individëve dhe të të vetëpunësuarve të vetëm, që kanë statusin e personit të verbër, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, personit me

surdomutizëm dhe invalidit të punës të provuar me vërtetimin përkatës të lëshuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të fushës.”.

Neni 3

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Të ardhurat e tatueshme nga punësimi tatohen me normat progresive të mëposhtme:

Baza tatimore vjetore	Norma tatimore
0 – 3 240 000 lekë	13%
3 240 001 – 8 040 000 lekë	23%
Mbi 8 040 000 lekë	30%”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Të ardhurat nga investimi tatohen me normën 15%.”.

Neni 4

Në pikën 3, të nenit 27, pas fjalëve “... dhe pasqyrat e raportimit financiar ...” shtohen “..., sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 61, të këtij ligji, ...”.

Neni 5

Në nenin 41, fjalia e dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Norma tatimore për dividendët është 15%, pa zbritur asnjë kosto.”.

Neni 6

Neni 59 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 59
Norma e mbajtjes së tatimit në burim

Norma e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat dhe pagesat, sipas nenit 58, të këtij ligji, është 15%.”.

Neni 7

Në pikën 5, të nenit 61, bëhen ndryshimi dhe shtesat, si më poshtë:

1. Fjalia e dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

   "Tatimpaguesit, që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin pranë organeve tatimore deklaratën vjetore dhe të dhënat e tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.".

2. Pas fjalisë së dytë shtohen fjalitë, me këtë përmbajtje:

   "Pasqyrat financiare paraqiten pranë organeve tatimore vetëm nga tatimpaguesit që nuk kanë detyrimin e depozitimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Për tatimpaguesit që kanë detyrimin për depozitimin e pasqyrave financiare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, ato depozitohen brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin përkatës. Qendra Kombëtare e Biznesit ia përcjell administratës tatimore elektronikisht.

   Përjashtimisht, për pasqyrat financiare që i përkasin vitit tatimor 2026, vijon të zbatohet detyrimi për depozitimin e tyre edhe pranë administratës tatimore.".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2027.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.29/2023, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ